



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, blloku i radhës i seancave gjyqësore përfundoi të enjten e kaluar. Dëshmitari i 36-të i thirrur nga Prokuroria, z. Sadik Halitjaha, pritet të vazhdojë dhënien e dëshmisë gjatë seancës gjyqësore të ardhshme, më 4 dhjetor.

Më 17 nëntor, në të njëjtën çështje gjyqësore, Zyra e Prokurorit të Specializuar parashtroi një kërkesë urgjente për ndryshim të kushteve të paraburgimit të z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi. Versioni i redaktuar publik i kërkesës u lëshua dje dhe gjendet në faqen e internetit të DSK-së.

Në këtë parashtrim, Prokuroria pretendon se të akuzuarit kanë shkelur urdhrat e Trupit Gjyqësor, duke zbuluar identitetet e dëshmitarëve të mbrojtur dhe/ose duke ua shpërndarë përmbajtjen konfidenciale të dëshmive personave që i kanë vizituar në objektin e paraburgimit. Prokuroria pretendon gjithashtu se hetimet kanë zbuluar tentime të mëtejshme për të penguar procesin gjyqësor, përfshirë dhënien e udhëzimeve se si duhet të japin dëshmi dëshmitarët dhe planet për kontaktimin e dëshmitarëve.

Gjithashtu në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, dje u lëshua versioni i redaktuar publik i Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtësit Kujdestar për Shtyrje të Dëshmisë së W04577-ës, që tani gjendet në faqen e internetit. Vendimi ka të bëjë me dëshmitarin e 29-të të thirrur nga Prokuroria në këtë çështje gjyqësore. Në vendim, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e mbrojtësit kujdestar për shtyrje të dëshmisë së dëshmitarit, bazuar në faktin se psikologu i Zyrës për Mbrojtje dhe Mbështetje të Dëshmitarëve konstatoi se dëshmitari aktualisht nuk është në gjendje të japë dëshmi dhe se palët nuk e kundërshtuan kërkesën e mbrojtësit kujdestar. Trupi Gjyqësor miratoi shtyrjen e dëshmisë së dëshmitarit deri në një njoftim të ardhshëm dhe deri kur Trupi Gjyqësor të bindet se dëshmitari është në gjendje të japë dëshmi.

Seancat në gjykimin e Pjetër Shalës po mbahen këtë javë dhe vazhdojnë dhe javën tjetër. Më 20, 21 dhe 22 nëntor, dha dëshmi dëshmitari i pestë, z. Zijadin Hoxha. Më 22 nëntor, filloi dhënien e dëshmisë dëshmitarja e gjashtë e thirrur nga Mbrojtja, znj. Safete Hadërgjonaj, dëshmia e së cilës përfundoi sot. Dëshmitarja e shtatë e thirrur nga Mbrojtja, Time Kadrijaj, filloi dhënien e dëshmisë sot.

Më 20 nëntor, Trupi Gjyqësor vendosi lidhur me vazhdimin e paraburgimit të Pjetër Shalës. Gjykatësit konstatuan se vazhdon të ekzistojë rreziku që i akuzuari të pengojë procesin gjyqësor dhe/ose të kryejë krime të tjera, përfshirë kundër dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi ose që do të japin dëshmi në këtë proces gjyqësor. Në lidhje me lirimin e përkohshëm, Trupi Gjyqësor gjykoj se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve të zbatueshme në objektin e paraburgimit të DHS-së.





Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

